



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Lënda: Mbi kërkesën për informacion në lidhje me punësimin në administratën publike të të diplomuarve me diplomë profesionale

REPORT TV

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, protokolluar me tonën nr. 5438, datë 27.10.2023, në lidhje me punësimin në administratën publike të të diplomuarve me diplomë profesionale, ju sqarojmë si vijon:

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike (DAP) është njësi përgjegjëse për institucionet e administratës shtetërore. Në këtë kuptim, DAP, ndër të tjera, organizon procedurat e konkurrimit për pozicionet vakante pjesë e shërbimit civil, në institucionet si: Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave.

Për t’u bërë pjesë e këtyre procedurave, kandidatët duhet të plotësojnë:

- a. kërkesat e përgjithshme për praninë në shërbim, të përcaktuara në ligjin e sipërpërmendur; si dhe
- b. kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme, në përputhje me përcaktimet në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar, dhe në përshkrimet e punës të pozicioneve vakante për të cilat zhvillohet konkurrimi.

Në VKM-në nr. 142/2014, të ndryshuar, përcaktohet niveli minimal arsimor i domosdoshëm për t’u punësuar në një pozicion pune në shërbimin civil. Një përcaktim i tillë është bërë bazuar në arsyetimin se cili është niveli minimal arsimor që mundëson që nëpunësi në pozicionin përkatës, të mund të ketë njohuritë e domosdoshme për të realizuar detyrat që i ngarkohen. Konkretisht, detyrat që i ngarkohen një nëpunësi civil jepen në mënyrë të përmbledhur në përkufizimin e dhënë për nëpunësit civilë në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar, sipas të cilit “*Nëpunës civil është personi që kryen funksionin për ushtrimin e autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit, i cili merr pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e*

mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.”. Në këtë drejtim, nivelet e diplomave të domosdoshme për të siguruar që nëpunësi civil zotëron njohuritë e nevojshme për të realizuar detyrat, i përkasin një prej cikleve të studimit (pra ciklit të parë, të dytë apo të tretë), sipas ligjit për arsimin e lartë. Si rrjedhim, niveli më i ulët i diplomës është diploma “Bachelor”.

Kriteret minimale në lidhje me arsimin, përvojën e të tjera, të përcaktuara në VKM-në nr. 142/2014, të ndryshuar, janë të detyrueshme për zbatim edhe nga institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat i organizojnë vetë procedurat e konkurrimit për pozicionet vakante në shërbimin civil. Kjo do të thotë që edhe në rastin e këtyre institucioneve, kriteri minimal i diplomës që duhet të zotërojë një kandidat për t’u punësuar në shërbimin civil, është e nivelit “Bachelor”.

I njëjti arsytim i shpjeguar më lart, është mbajtur parasysh për të përcaktuar nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, edhe në kuadër të vendimit nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Ky vendim përcakton elementet përbërës të pagës bruto mujore dhe vlerat për secilin element të tyre, për funksionarët e kabineteve, nëpunësit civilë dhe nëpunësit e institucioneve që nuk kanë statusin e nëpunësit civil. Një nga elementet përbërës të pagës së tyre është shtesa e nivelit të kualifikimit, që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës. Edhe në rastin e pozicioneve të punës jo shërbim civil, për shkak të natyrës së tyre të punës, e krahasueshme për nga përgjegjësia me atë të nëpunësve civilë, kërkohen njohuri të tilla që përfitohen në një prej cikleve të studimit të arsimit të lartë.

Pra, në konkluzion për pozicionet e punës të përmendura më lart, për shkak të njohurive dhe aftësive të nevojshme që duhet të kenë nëpunësit e emëruar në këto pozicione, është i pamundur punësimi i individëve që zotërojnë diplomë profesionale të arsimit të lartë.

Përveç sa më sipër, pjesë e institucioneve të administratës publike janë edhe punonjësit administrativë/mbështetës, të cilët nuk ushtrojnë funksione publike, por kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi dhe ruajtjeje. Për këto pozicione pune nuk kërkohet domosdoshmërisht një diplomë e një prej cikleve të studimit të arsimit të lartë, pra ekziston hapësira ligjore për punësimin në këto pozicione të të diplomuarve me diplomë profesionale të arsimit të lartë.

Bazuar në VKM-në nr. 326, datë 31.5.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, struktura e pagës së punonjësve mbështetës nuk e përfshin elementin e pagës së diplomës, por vetëm pagën bazë për klasën e pozicionit dhe shtesa të tjera që aplikohen sipas përcaktimeve nënligjore.

Për këta të fundit, DAP nuk disponon të dhëna për numrin e punonjësve administrativë/mbështetës që zotërojnë diplomë profesionale të arsimit të lartë apo për profilin e tyre të diplomimit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,